

JORGJI GJINARI

## MENDIME MBI TRAJTIMIN E SHNDËRRIMEVE FONETIKE NË «GRAMATIKËN E GJUHËS SË SOTME LETRARE SHQIPE»

Në *Gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe* që po harton Instituti i historisë dhe i gjuhësisë në bashkëpunim me Fakultetin e historisë e të filologjisë, do të ketë edhe një kapitull ku do të trajtohen shndërrimet fonetike që vërehen në format e ndryshme që merr fjala gjatë fleksionit edhe në fjalëformim.

Në përputhje me gjendjen e sotme të gjuhës letrare kombëtare shqipe, «Gramatika» që po hartohet, do të mbështetet në kritere disi të ndryshme nga ato të gramatikave të mëparshme.

Këtu do të japim disa mendime rreth kriterëve dhe mënyrës së trajtimit të dukurive fonetike të shqipes së sotme letrare në kapitullin përkatës të kësaj «Gramatike».

Mendojmë se do të jetë e dobishme që të rrihen e të shkëmbehen mendime edhe për probleme të tjera të «Gramatikës».

Duke iu përmbajtur kriterëve themelore të «Gramatikës», edhe në kapitullin mbi shndërrimet fonetike duhet të trajtohen ato dukuri që janë veçori të *gjuhës së sotme letrare shqipe*, ato që përbëjnë normën e ngulitur dhe normat variante të përbashkëta të gjuhës letrare shqipe të ditëve tona. Kur themi se do trajtohet gjuha e ditëve tona, nuk mohojmë faktin se gjuha e sotme letrare shqipe ka filluar të formohet si gjuhë letrare kombëtare që nga koha e Rilindjes; kjo e vërtetë do të kihet parasysh edhe në zgjedhjen e shembujve për kapitullin mbi shndërrimet fonetike, të përfaqësohet gjithë periudha që nga Rilindja e deri sot, vetëm se duke u mbështetur në kriterin që shembujt e çdo faze të përputhen me normën e përbashkët të ditëve tona.

Kuptohet vetvetiu që në këtë kapitull duhet të përjashtohen dukuritë fonetike të dialekteve të shqipes, të cilat në gramatikat e derisotme edhe janë bërë objekt trajtimi. Sigurisht do të kihet parasysh edhe varianti i shkruar edhe varianti i folur i gjuhës letrare, por për disa arsye që do të shpjegohen më poshtë, varianti i folur nuk mund dhe nuk duhet trajtuar me gjithë plotësinë e tij. Nga stilet e gjuhës së shkruar do mënjanuar vetëm gjuha e poezisë, sepse mendojmë që sot ajo ende nuk ka formuar një rregullshmëri të vetën, vërehen përdorime arkaizmash e dialektizmash pa kriter, sipas rastit e në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Në qoftë se nuk mënjanohet, mundet që për gjuhën e poezisë të bëhen shpjegime me shënime të veçanta.

Në kapitullin e shndërrimeve fonetike të bëhet grupimi i dukurive të ndryshme sipas një kriteri të rërcaktuar (fonetiko-fonematik), të nxirren normat dhe ligjshmëria e shndërrimeve fonetike duke i shpjeguar brenda kuadrit të gjuhës së sotme letrare shqipe. Prej pjesës së fonetikës, në

mënyrë të veçantë ky kapitull do të shërbejë edhe për shpjegimin dhe njohjen e strukturës së fjalës si në planin e formëformimit dhe në atë të fjalëformimit.

\* \* \*

Shndërrimet fonetike që ndodhin në fjalë janë disa llojesh, ka: 1) *shndërrime mekanike* që janë të kushtëzuara fonetikiisht, të cilat ose shkaktohen prej ndikimit të tingujve fqinjë mbi njëri-tjetrin (*kombinatorë*) ose prej vendit të tingullit në fjalë në lidhje me theksin e fjalës, me llojin e rrokjes etj. (*pozicionale*) dhe 2) *këmbime tingujsh* (alternime) të gjalla (fonetike) dhe *historike* që nuk kushtëzohen sot fonetikiisht, që nuk shpjegohen me ligjet dhe normat e sotme fonetike të gjuhës.

Shndërrimet mekanike mund të jenë: shndërrime *nuancash të fonemave* (ndryshime nuancash e timbresh të tingujve që nuk shkaktojnë kalime nga një fonemë në tjetrën), p.sh. velarizimi e ndryshime të tjera të timbrimit të *i*-së që ndodhet pranë *ll*-së, ndryshimet (më e prapme, më e përparme) që pëson *k*-ja kur ndodhet para *i*-së, *u*-së etj., ndryshimet e gjatësisë së zanoreve kur kalojnë nga të theksuara në të patheksuara e anasjelltas ose nga rrokje të hapta në rrokje të mbyllura etj.; mund të jenë shndërrime fonemash, si p.sh. *s'bëj* > *z'bëj*, *s'gjej* > *z'gjej*; *cen* > *cënoj*, *gaz* > *gëzoi* etj. dhe zhdukje tingujsh, p.sh. *emër* > *emri*, *të zott* > *të zot*, *pais* > *pais* etj.

*Këmbimet* (alternimet) janë zëvendësime fonemash me njëra-tjetrën që nuk kushtëzohen sot fonetikiisht, p.sh. në këmbimet e gjalla (fonetike): shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: *elp* (elb), *zok* (zog) etj. dhe në këmbimet historike: *dal*: *dole*, *punova*: *punuam*, *bujk*: *bujq* etj. Këmbimet historike kanë vlerë gramatikore, dallojnë sot format e ndryshme gramatikore që merr fjala gjatë fleksionit të saj.

«Gramatika» do t'i trajtojë të dyja llojet e shndërrimeve fonetike, edhe shndërrimet mekanike, edhe këmbimet (alternimet), por mendoj se nuk duhet të përfshijë të gjithë vëllimin e tyre, duhet të lërë jashtë trajtimin një pjesë, dhe pikërisht të lërë jashtë dukuri fonetike që janë karakteristike për variantin e folur të gjuhës sonë letrare. Kjo duhet bërë, sepse norma e përbashkët në shqiptimin e gjuhës së sotme letrare shqipe ende nuk është studjuar mirë dhe, veç kësaj, duhet thënë se ajo edhe nuk është kristalizuar ende në masën e normës së variantit të shkruar.

Ndërmjet këtyre dukurive fonetike të variantit të folur duhen bërë disa dallime e shkallëzime për shkaqe të ndryshme. P.sh. modifikimet që nuk sjellin ndryshime fonematike, modifikimet që pësojnë tingujt në nuanca e në timbre gjatë rrjedhës së të folurit për shkak të ndikimit të tingujve fqinjë e të pozitës së tyre në fjalë, duhen përjashtuar kategorikiisht prej trajtimit, sepse pothuajse nuk janë studjuar aspak dhe është vështirë të gjesh sot për këto shqiptimimin më të përgjithshëm. Pas këtyre vijnë dukuri të tilla si ajo e rënjes së tingujve, po për shkak të ndikimit të tingujve fqinjë e të pozitës së tyre, si: *të zott* > *të zot*, *vritte* > *vrite*; *njerëzit* > *njerzit*, *Kukësi* > *Kuksi*, *shumë i zoti* > *shum'i zoti*, *bukë e bardhë* > *buk'e bardhë*, *armët e tij* > *armt'e tij*, *të provoj* > *t'provoj*, *të egra* > *t'egra* etj.; si dhe këmbime (alternime) të gjalla (fonetike), si ai i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës që nuk janë pasqyruar në shkrim (në drejtshkrimin e sotëm). Për shndërrime të këtilla nuk ka akoma një normë të ngulitur dhe me vështirësi mund t'u gjendet drejtimi që kanë marrë, por, megjithatë, ato mund

të bëhen objekt trajtimi për t'i përshkruar me shpjegime si dukuri që vërehen në gjuhën tonë të sotme. Në radhë të tretë vijnë ato shndërrime mekanike të kushtëzuara që janë ngulitur si normë e përbashkët në gjuhën e folur dhe që u dihet mirë drejtimi që kanë marrë sot në gjuhën letrare, p.sh. sonorizimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta kur ndodhen pranë bashkëtingëlloreve të zëshme: *s'dua* > *z'dua*, *s'bëj* > *z'bëj*, *s'gjej* > *z'gjej* etj.; *ngjit* > *njgjit*, *qengj* > *qenjgj*, *ngas* > *ngas*, *kënga* > *kënga* etj.; *ujit* > *uit*, *pajis* > *pais*, *çaji* > *çai* etj. Trajtimi i shndërrimeve të këtilla nuk është i vështirë dhe duhet bërë patjetër. Dukuri fonetike të kësaj natyre janë pasqyruar edhe në gjuhën e shkruar, p.sh. *zhvilloj*, *zhduk*, *zhbiroj* etj. (krh.: *shkarkoj*, *shkul*); *ja dha* (krh. *i dha*), *zegli*, *e vjetra* (krh.: *zegël*, *e vjetër*); *zjeva*, *ndjeva* (krh.: *ziej*, *ndiej*) etj.

«Gramatika» do të përshkruajë gjendjen e sotme të gjuhës letrare shqipe, prandaj, në përputhje me karakterin e saj përshkruar, edhe në kapitullin mbi shndërrimet fonetike duhet të vështrohet vetëm struktura e sotme e fjalës, ajo që dallohet e që zbulohet lehtë prej shqipfolësit e jo struktura historike për dallimin e së cilës kërkohen analiza etimologjike. P.sh. si raste ndryshimesh fonetike në strukturën e sotme do të shihen: në formëformim: *mapo*: *mapua* dhe *mapo*; *mapoja*; *punë*: *puna*; *lule-luleje-lulja*; *më tha*: *m'i dha*; *të tha*: *t'i dha*; *ka thënë*: *thënkam*, *ka mbjellë*: *mbjellkam* (në format e habitores nuk zbulohet lehtë struktura, prandaj ato edhe mund të merren si raste që i takojnë gramatikës historike e të mos trajtohen në kapitullin tonë); *i madh*: *të mëdhenj*, *i keq*: *të këqinj*; *emër*: *emri*, *i vogël*: *i vogli*; *zog*: *zogj*, *kapitull*: *kapituj*; *dash*: *desh*, *plak*: *pleq*; *fle*: *flini*, *mbjell*: *mbillni*, *marr-merr-mirri-mora*, *shkruaj-shkrova*, *lyej-leva*, *nxjerr-mora*, *djeg-dogja*, *pata*: *kam pasur*, *flas*: *flet*, *lë*: *(kam) lënë*: *lashë*, *vë-vura*; *shkruaj*: *shkruhem* përzier: *përzihem*; në fjalëformim: *zhdredh*, *zhbëj*, *zhvilloj*, *zhblokoj*: *shkarkoj*, *shfryj*, *shpalo*, *shtrydh*; *cen*: *cënoj*, *shenj*: *shënoj*, *punë*: *punoj* (?); *punëtor*, *afër*: *afroj*, *tepër*: *tepricë*, *kundër*: *kundrejt*, *thekës*: *pastheksore*; *gjithë*: *i përgjithshëm*; *ledhë*: *përkëdhel*, *nerv*: *nevrik* (?), *gushtovjeshhtë*, *gushakuq*, *dashmirë*: *ballaballë*, *atdhe*, *bashkatdhetar*, *gjithandej*, *gjysmanalfabet*; *dalngadalë*: *dalë*, *gjithmonë*: *gjithë* etj. Mund të përfshihen këtu edhe ndryshime të gjatësisë së zanores që lidhen me ndërrimin e vendit të theksit në

fjalë, si: *fshat*; *fshatër*, ose në formë-formim: *gjarpër*: *gjarpërinj*, megjithëse ndryshimi i gjatësisë së zanores nuk ka vlerë fonematike në gjuhën tonë letrare.

Nuk duhet të shqyrtohen në këtë kapitull shndërrimet fonetike që vërehen në rastet kur sot struktura e fjalës nuk dallohet lehtë, kur për njohjen e saj kërkohen shpjegime që lidhen me historinë e gjuhës (ato do të trajtohen në fonetikën dhe gramatikën historike), si p.sh.: *fytyrë* < *fëtyrë*, *ti-ty-teje*, *ato-atyre*, *më tha*: *ma dha*, *e pa*, *i tha*: *ja dha*: *e pa*, *hënë<sup>1</sup>-s*: *kumbull-ës*: *shhtëpi-së*, *male-t*, *barinj-të*, *nxënës-it*, *dhen-sh*: *vjet-ësh*: *peshq-ish*, *ka-në*; *mal-in*: *ujk-un*, *e një mali*: *e një zogu*, *vrit-em*: *la-hem*, *qepa*: *ble-va*, *qep-ëm*: *ble-më* etj. dhe *ngarkoj*: *shkarkoj*, *ngul*: *shkul*, *mbërthej*: *shpërthej*, *gjithmonë*: *motin* (\**motnë*), *mjaft* (\**me aft*), *këtej*:

1) Në raste të këtilla, kur në gjendjen e sotme të gjuhës një mbaresë del në disa variante, trajtimi i dukurive fonetike në këtë kapitull është shumë i lidhur me trajtimin e këtyre mbaresave në pjesën «Morfologjia». Besoj se edhe *Morfologjia* do t'i vështrojë këto variante mbaresash si formante të veçanta nga pikëpamja e gjendjes së sotme të gjuhës.

*andej, sonte* (\*so+nate), *sivjet* \*(kë) si+vjeti), *mbasi* (\*m+pas+si); *plan dyvjeçar*: *punë dyvjetëshe* etj.

Veç shndërrimeve mekanike dhe këmbimeve (alternimeve), në gjuhë gjatë fleksionit dhe në fjalëformim vërehen edhe shndërrime fonetike të tjera që nuk lidhen as me veprimin e normave e ligjeve fonetike të sotme dhe as me ato historiket, por që në historinë e formimit të gjuhës letrare shpjegohen me bashkëveprimin e dialekteve ose me ndikimin e gjuhëve të huaja gjatë huazimit të fjalëve, p.sh. *tashma* (më), *asgjamangut* (asgjë), *thelb*: *thelpinj*; *muaj*: *mujor*; *kam mësuar*: *mësues*; *dashuri*: *dashnor*; *çarmatim*, *çmallem*, *çnderim*, *çliroj*, *çnjerëzor* (krahaso për këto të fundit rastet përgjegjëse ku *sh*-ja, megjithëse ndodhet në po ato kushte fonetike, nuk shndërrohet në ç: *shapka*, *shmangem*, e *lodhshme*, *shndërroj*, *thoshnin*, *shlivi*, *veshël-veshla*); *nerv*: *nevrastenik*; *nevralgji* etj.

Shndërrime fonetike të këtilla formojnë një grup më vete dhe mund të trajtohen veçmas ose duke u shpjeguar në formë shënimi. Sigurisht, këto lloj shndërrimesh janë objekt i historisë së gjuhës sonë letrare, por duke qenë se struktura e fjalëve ku vërehen ato dallohet mirë sot prej shqipfolësit, është e nevojshme që të trajtohen edhe në «Gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe».

Në kundërvënjen e formave gramatikore, të fjalëve dhe formanteve që do të bëhet gjatë përshkrimit dhe shpjegimit të shndërrimeve fonetike prej krahëve të krahasimit do të merren si bazë ato forma, fjalë dhe formante që janë *kryesore nga pikëpamja e gjendjes së sotme të gjuhës sonë* e jo ato që janë *primare historikisht*. Kështu ndërmjet rasteve të formëformimit si forma bazë duhet të merren këto: në sistemin emëror: e pashquara (*zegël* — zegli, *punë* — puna), numri njëjës (*plak* — pleq, *mashkull* — meshkuj, *i madh* — të mëdhenj etj.), rasa emërore (*bukë* — buke, *lule* — luleje etj.), gjinia mashkullore (*i ardhshëm* — e ardhshme etj.); në sistemin foljor duhet të merren: e tashmja (*marr* — mora, *bluaj* — blova, *djeg* — dogja, *mbjell* — mbillja, *shkruaj* — shkruhesha etj.), e kryera e thjeshtë në krahasim me pjesoren (*pata* — (kam) pasur), *dhashë* — dhënë etj.), veta e parë njëjës (ose shumë, sipas rastit) (*marr* — merr, *flas* — flet, *punova* — punuam, *njoh* — njeh) etj.; ndërmjet rasteve të fjalëformimit duhet të merren si bazë: në prejardhje: fjala (tema) rrënjë (*cen* — cënoj, *afër* — afroj, *gjithë* — i përgjithshëm, *ledhë* — përkëdhel etj.), në kompozim do të merren fjalët (temat) që marrin pjesë në kompozim (*ballë* — ballaballë, *atë*, *dhe* — atdhe etj.) dhe në përngjitje do të merren fjalët si komponente të fjalës së formuar (*dalë*, *nga* — dalgadalë etj.).

Duke qenë se «Gramatika» do të ketë karakter përshkrues, në kapitullin e shndërrimeve fonetike nuk duhet të bëhen ekskurse historike (mundet vetëm në ndonjë rast të rrallë, si në *thënkam*: *thënë* e ndonjë tjetër). Po për këtë arsye nuk do të lindë edhe nevoja e emërtimit të disa fenomeneve me terma që lidhen dhe që kuptohen me historinë e gjuhës, si p.sh. termat: palatalizim, metafoini, apofoni, sinkopë, aferezë etj.

Kapitulli duhet të fillojë me një hyrje teorike (rreth dy faqe) mbi shndërrimet fonetike. Shpjegime teorike do të bëhen edhe për llojet e veçanta (sipas tipeve) të shndërrimeve fonetike gjatë trajtimit të tyre në kapitull.

Ashtu si në gramatika të gjuhëve të tjera, në këtë kapitull shembujt duhet të jepen pa referime dhe pa kontekst.

Duke u mbështetur në karakterin përshkrues të «Gramatikës», mendojmë që kapitulli i shndërrimeve fonetike të përshkohet nga kriteri fonetiko-fonematik dhe të ketë këtë skemë ndërtimi:

## I. SHNDËRRIME MEKANIKE

## A. K o m b i n a t o r e

1. *Shndërrime tingujsh*
2. *Zhdukje tingujsh*
3. *Lindje tingujsh*

## B. P o z i c i o n a l e

1. *Shndërrime tingujsh*
2. *Zhdukje tingujsh*
3. *Lindje tingujsh*

## II. KËMBIME (alternime)

## A. T ë g j a l l a (fonetike)

1. *Shndërrime tingujsh*
2. *Zhdukje tingujsh*
3. *Lindje tingujsh*

## B. H i s t o r i k e

1. *Shndërrime tingujsh*
2. *Zhdukje tingujsh*
3. *Lindje tingujsh*

II. SHNDËRRIME TË TJERA (*prej bashkëveprimit të dialekteve dhe prej huazimit*).

1. *Shndërrime tingujsh*
2. *Zhdukje tingujsh*
3. *Lindje tingujsh*

